

Projekti i heqjes së linjës hekurudhore nga kyqëzimi midis hekurudhës dhe rrugës Webster

Ne jemi duke hequr 27 vendkalime të linjës hekurudhore dhe rrugëve ne linjat e trenit Cranbourne dhe Pakenham, duke liruar rrugët nga trau i barierës automatike, gjë e cila do të krijojë në këto linja më shumë hapësirë për 121.000 pasagjerë çdo javë kur të hapet tuneli i metrosë.

Ne po heqim vendkalimin e rrezikshëm dhe të mbipopulluar në rrugën Webster, Dandenong.

Vlerësimet teknike dhe inxhinierike kanë përcaktuar se zgjidhja më e mirë për rrugën Webster është mbyllja e rrugës për automjetet në kryqëzimin e linjës hekurudhore me rrugën dhe ndërtimi i një rruge të re nën linjën hekurudhore, që lidh rrugën Princes Highway-Lonsdale me rrugët Cheltenham dhe Hammond.

Heqja e këtij kryqëzimi të linjës hekurudhore me rrugën do të përmirësojë

sigurinë për shoferët, këmbësorët dhe çiklistët e do të përgatisë zonën për zhvillimin e ardhshëm.

Mbyllja e kryqëzimit të linjës hekurudhore me rrugën dhe ndërtimi i një lidhjeje të re rrugore

Ne po ndërtojmë rrugën e re nën linjën hekurudhore duke ndryshuar mënyrën se si njerëzit udhëtojnë rreth Dandenong-ut për më mirë. Lidhja e re do të reduktojë mbingarkimin e trafikut në rrugë, do të ofrojë një rrjet rrugor më të besueshëm dhe do të përmirësojë sigurinë.

Një lidhje e re nga lindja deri në perëndim

Ne do të lidhim kryqëzimin ekzistues të rrugëve Cheltenham dhe Hammond me rrugën Princes Highway-Lonsdale duke gërmuar një rrugë të re poshtë linjës hekurudhore.

Automjetet që do të udhëtojnë nga perëndimi në lindje përmes nënkalimit do të mund të kthehen majtas ose djathtas për në rrugën Princes Highway-Lonsdale nëpërmjet një kryqëzimi të sinjalizuar.

Rruga Webster do jetë më e sigurt dhe më e qetë


Me mbylljen e kryqëzimit të linjës hekurudhore me rrugën, do ketë më pak automjete të cilat do të udhëtojnë në rrugën Webster si dhe automjetet e rënda do të largohen nga rrugët e banuara dhe nga qendra e Dandenong-ut, duke e bërë atë më të qetë dhe më të sigurt për njerëzit që jetojnë atje.

Njerëzit e komunitetit do të hyjnë që nga skaji perëndimor i rrugës Webster nëpërmjet rrugëve Hammond dhe Bryants dhe skaji lindor i rrugës Webster do të përdoret nëpërmjet rrugës Princes Highway-Lonsdale.


Këmbësorët në rrugën Webster do të jenë ende në gjendje të kalojnë nga njëra anë e linjës hekurudhore në tjetrën, por vendndodhja e rrugicave është ende duke u finalizuar.

Ndryshimet në rrugën Thomas

Rruga Thomas do të shndërrohet në një rrugë pa kalim ku mund të hyet/përdoret nëpërmjet rrugës Foster me një zonë të re për t'u kthyer e cila do të ndërtohet në fund të rrugës.



Kryqëzimi i ri ku nënkalimi i ri rrugor lidhet me rrugën Princes Highway-Lonsdale. Puna e artistit, mund të ndryshojë.



Afati kohor i projektit

Ne do të mbyllim rrugën Webster në vendin e kryqëzimit të linjës hekurudhore me rrugën në 2025 dhe nënkalimi i ri rrugor do të hapet në vitin 2028.

Ne flasim gjuhën tuaj

Ne kemi në dispozicion shërbimet e përkthimit për t'ju ndihmuar të merrni informacion rreth projektit në gjuhën tuaj.

Për të marrë shërbimet me përkthyes në gjuhën tuaj telefononi **9209 0147**.

Për informacion mbi projektin ne shqip vizitoni **levelcrossings.vic.gov.au/webster-albanian**



2018

- Njoftimi i projektit për heqjen e kryqëzimit të linjës hekurudhore me rrugën

2022 deri në fund të vitit 2023

- Shqyrtimi i vendit, sondazhet e trafikut dhe planifikimi i punimeve

Nëntor 2023

- U publikuan dizajnet e konceptit
- Konsultimet me komunitetin
- Shqyrtimet në vendin e punës vazhdojnë

2024

- Dizajnet përfundimtare të publikuara
- Angazhimi i mëtejshëm i komunitetit
- Puna fillestare e ndërtimit

2025

- Fillon ndërtimi kryesor
- Heqja e kryqëzimit të linjës hekurudhore me rrugën

2028

- Hapet nënkalimi i ri rrugor

* Afati kohor mund të ndryshojë.

levelcrossings.vic.gov.au

contact@levelcrossings.vic.gov.au



For languages other than English, please call 9209 0147.

1800 105 105 (call anytime)



Please contact us if you would like this information in an accessible format. If you need assistance due to a hearing or speech impairment, visit **relayservice.gov.au**

